



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MEDHA

VENDIM

Nr 4, Datë 5.7.2017

Për

Shqyrtimin e materialit lidhur me problematikën e zbatimit të punimeve në Digën e Hec-it Lumzi-Pukë.

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, si dhe neni 9, të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 30.06.2017, mori në shqyrtim materialin lidhur me problematikën e zbatimit të punimeve në Digën e Hec-it Lumzi-Pukë.

Projekt-zbatimi i digës është miratuar me vendimin nr 3 datë 08.07.2016 në këtë vendim është theksuar detyrimi i investitorit shoqërisë “M.C. INERTE LUMZI” Sh.p.k. që të sjellë për miratim mbikqyrësin e punimeve.

Kjo kërkesë është përsëritur dhe kërkuar nga KKDM me shkresat nr. 41.datë 15.08.2016 dhe nr 18. me datë 12.04.2017.

Në datën 14.06. 2017 me shkresën nr. 19 datë 30.05. 2017 shoqëria “M.C. INERTE LUMZI” shpk njoftoi për mbikëqyrsin e punimeve dhe kontratat përkatëse.

Në raportin e dërguar me shkresën nr.686/1 datë.29.05.2017 nga “GJEOKONSULT&CO” sh.p.k, thuhet se mbushja e provës për përcaktimin e treguesve është bërë në muajin dhjetor 2016 ndërsa kontrata e mbikqyrjes rezulton e nënshkruar në muajin prill 2017. Nga raporti i paraqitur rezulton se treguesit janë brenda kërkesave të projektit.

Mbas parashtrimin në mbledhjen e radhës së KKDM, mendimi i Këshillit Teknik dhe nga diskutimet e të gjithë anëtarëve të KKDM-së,

Vendosi:

- Shoqëria “M.C.INERTE LUMZI” Sh.p.k, të plotësojë të gjitha kërkesat e VKM 146, datë 18.03.2004 “Rregullores së sigurisë së digave dhe dambave” për realizimin e punimeve në mënyrë që të mund të jepet nga ky komitet autorizimi për mbushjen me ujë për herë të parë dhe vënien nën ngarkesë të digës. Investitori duhet të bëjë shumë kujdes për plotësimin e cdo kërkesë.
- Vëmë në dijeni Ministrinë përkatëse dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për ndjekjen e zbatimin e detyrimeve koncensionare, konform ligjeve në fuqi.
- Në mungesë të Inspektoriatit Teknik të Digave, të njoftohet dhe Inspektoriat i Kombëtar i Mbrojtjes së Teritorrit, për të ushtruar kontrollin e nevojshëm për verifikimin e plotësimin e detyrimeve ligjore sipas ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Me respekt,

Inxh.Maksim Muçi

K R Y E T A R

